



UNIVERSITETI
BARLETI

Deloitte.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT BARLETI

DHE

DELOITTE ALBANIA

TIRANË

ME DATË 05/10/2022



UNIVERSITETI
BARLETI

Deloitte.

mësuesi në sporte, dizajn, shken- ca sociale, arkitekturë, urbanistikë, etj dhe krijojnë mundësi jo vetëm për programe akademike të të tre niveleve por dhe për formim profesional nëpërmjet programeve të veçanta. Në rrugëtimin e tij, institucioni ka mundësuar jo vetëm studimet profesionale dhe të aplikuara universitare, e pasuniversitare, por dhe shërbime të tjera si ato të testimit dhe programeve të trajnimit të vazhdueshëm profesional dhe liçensimit, nëpërmjet bash- këpunimeve të shumëllojshme me organizma profesionale, shoqata dhe punëdhënës.

C. Ekziston një vullnet i lirë i palëve që të bashkëpunojnë në arritjen e qëllimeve të perbashkëta për:

- ✓ Shkëmbimin e eksperiencave më qëllim realizimin e praktikës mësimore dhe punësimit të studentëve dhe të të diplomuarëve në Universitetin BARLETI.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e asistencave teknike dhe profesionale reciproke duke vënë në dispozicion kapitalin intelektual të palëve.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e iniciativave të përbashkëta për aplikimin në projekte, në programe të edukimit afat shkurtër, konsulencave të specializuara, etj.
- ✓ Aplikimi dhe Implementimi i projekteve dhe programeve të financuara me fondet e EU, apo donatoreve të ndryshëm nderkombëtar si USAID, WB, IFC, EBRD, Qeveria Shqiptare, dhe jo vetëm.



UNIVERSITETI
BARLETI

Deloitte

9. Universiteti BARLETI do të zhvillojë tarifa preferenciale për të gjitha studimet, konsulencat, këshillimet apo trajnimet që do të realizojë për Deloitte.
10. Të gjitha veprimtaritë e listuara më lart në këtë nen, do të kryhen me dakordësinë e palëve dhe sipas mundësive dhe diskrecionit të tyre.

NENI III

KUSHTET E BASHKEPUNIMIT

1. Kjo marrëveshje Bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve përveç rasteve kur palët bien dakort ndryshe.
2. Kostot dhe shpenzimet që lindin nga kjo marrëveshje do të mbulohen nga secila palë me buxhetin e tyre.
3. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me anë të marrëveshjes së vecantë financiare, të cilat do të jenë pjese integrale e kësaj Marrëveshje.
4. Të dy palët, në bazë të mundësive, mjeteve financiare që disponojnë dhe potencialit akademik e professional, do të aplikojnë në organizma dhe institucione të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta.
5. Rezultatet e këtij bashkëpunimi dhe përfitimet reciproke kur ato ekzistojnë bëhen publike vetëm me aprovimin e të palëve. Palët ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të perfituara nga njëri-tjetri.
6. Palët dakordohen që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

NENI VI

KONFIDENCIALITETI

1. Asnjëra nga palët nuk do t'i përdorë dhe nuk do t'ju tregojë të tretëve informacionet konfidenciale të palës tjetër, apo informacionet e përbashkëta sipas dispozitave ligjore të përcaktuara. Të dy palët do të zbatojnë masat e sigurisë në mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e informacionit për të mbrojtur nga qasja e paautorizuar, ndryshimi, zbulimi ose shkatërrimi i të dhënave personale.
2. Universiteti BARLETI do të mbajë në mirëbesim për përfitimin e vetëm të Deloitte çdo material, informacion apo ide që i janë ofruar apo siguruar Universiteti BARLETI nga Deloitte, ose janë përvetësuar apo mësuar nga Universiteti BARLETI në lidhje me këtë Marrëveshje, qoftë para apo pas datës së specifikuar në këtë marrëveshje (këtu e tutje referuar si "Informacion Konfidencial"). Universiteti BARLETI nuk do përdorë, riprodhojë apo zbulojë asnjë informacion konfidencial, përveç në masën që është e



UNIVERSITETI
BARLETI

Deloitte

NENI VI

HYRJA NE FUQI DHE KOHËZGJATJA

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit mes palëve dhe lidhet për një periudhë trevjecare, me të drejtë rinovimi pas kërkesës dhe pëlqimit të dy palëve. Kjo kontratë rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në republikën e Shqipërisë. Ajo mund të ndryshohet në cdo moment nëse palët bien dakord dhe vetëm me anë të një dokumenti të shkruar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Kjo marrëveshje shfuqizon cdo marrëveshje ndermjet paleve.

Universiteti BARLETI

Dr. Rezart Prifti

Zv. Dekan

